

UDHËZIM
Nr. 5, datë 25.2.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 43, DATË 15.10.2014 TË
MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, "PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË
DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI
DHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE, PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015", TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 33, pikës 1 të nenit 34 dhe nenit 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 3 të udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, të ndryshuar, shtohet pika 3.1, si më poshtë:
"3.1 Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit për transferimin e studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2014-2015, në institucionet private të arsimit të lartë, të kryhen dhe në periudhën 25 shkurt 2015 deri më 16 mars 2015."
 2. Pas pikës 5 të udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, të ndryshuar, shtohet pika 5.1, si më poshtë:
"5.1 IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), brenda datës 20 mars 2015, listën e studentëve të regjistruar për transferim studimesh në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, në formë shkresore dhe elektronike (*hardcopy* dhe në CD). AKP-ja, brenda datës 20 prill 2015, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të private çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja me listat me numrat e matrikullimit."
 3. Pas pikës 6 të udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, të ndryshuar, të shtohet pika 6.1, si më poshtë:
"6.1 IAL-të private, deri në datën 24 prill 2014, dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat mbi regjistrimet e transferimit të studimeve të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë në formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010, "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore".
 4. Pika 17 e udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, i ndryshuar, shfuqizohet.
 5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet private të arsimit të lartë.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla